

Dt. 30.11. 2017

Shtojce:

Shtojcë për modifikim dokumentacioni, Dokumentat Standarte të Koncesionit dhe për shtyrjen e afatit të hapjes së ofertave në lidhje me procedurën e koncesionit/ppp me objekt: “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin,Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”

Të nderuar operatorë ekonomikë!

Pranë Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë, është paraqitur një kërkesë për sqarim në sistemin elektronik të app-së nga një operator ekonomik në datë 30.11.2017 në lidhje me dokumentat e koncesionit për procedurën e koncesionit/ppp me objekt: **“Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin,Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”**

Autoriteti Kontraktor pasi e ka marrë në shqyrtim kërkesën, vendosi:

Të bëjë një ndryshim në Dokumentat Standarte të Koncesionit për procedurën me objekt **“Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin,Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”** konkretisht

Në **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT/ Kapaciteti teknik: pika 3 ku konkretisht është shprehur se:**

Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) pesë drejtues teknikë të punimeve në objekt (drejtuesit teknik duhet te kenë secili më vete mbi **5 (njëzetë)** vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në CV perkatëse), te perfshire ne licensen e shoqerise dhe të deklaroje se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objektet përkatës, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- i. CV perkatëse
- ii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iii. Diplome

Ne procedurën e Koncesionit/PPP me objekt **“Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin,Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e pesë objekteve arsimore në Zonën Tirana 1”**,

- KY KRITER Ndryshohet si më poshtë:

Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) pesë drejtues teknikë të punimeve në objekt (drejtuesit teknik duhet te kenë secili më vete mbi **5 (pesë)** vjet eksperiencë pune e pasqyruar kjo në CV perkatëse), te perfshire

ne licensen e shoqerise dhe të deklaroje se do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objektet përkatës, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. CV perkatese
- ii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iii. Diplome

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor i cili administron të gjithë procesin vendosi në mbështetje të VKM Nr. 914 dt 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik"(i ndryshuar), neni 62 të zgjatë afatin kohor të proçedurës me dhjetë ditë:

Nisur nga sa më sipër sqarojmë se Hapja e ofertave **do të jetë** si më poshtë vijon:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 08.01.2018 Ora: 11:00

Vendi: ëëë.app.gov.al , Bashkia e Tiranës , Tiranë

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 08.01.2018 Ora: 11:00

Vendi: ëëë.app.gov.al , Bashkia e Tiranës , Tiranë